



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 5/580

Datë: 23 / 12 / 2022

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara në nenin 23 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2022, merr këtë:

VENDIM

- I. Shfuqizohet Vendimi me nr. prot. 1/630, datë 14.7.2016 i Këshillit Drejtues të UP-së, për plotësim-ndryshim të nenit 8, paragrafi 8.4 të Rregullores me nr. prot. 2/513, datë 25.10.2013, për themelimin dhe parimet e funksionimit të instituteve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".
- II. Vendimi i shfuqizuar nuk prodhon asnjë pasoja juridike.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i UP-së, në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2022, ka marrë vendim për shfuqizimin e Vendimit me nr. prot. 1/630, datë 14.7.2016, për plotësim ndryshim të nenit 8, të paragrafit 8.4 të Rregullores me nr. prot. 2/513, datë 25.10.2013, për themelimin dhe parimet e funksionimit të instituteve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina. Sipas paragrafit I të Vendimit me nr. prot. 1/630, datë 14.7.2016, 10% (dhjetë përqind) nga mjetet financiare të realizuara nga projektet dhe shërbimet e instituteve të UP-së, i janë ndarë personelit të rektoratit. Mbi këtë bazë janë ekzekutuar pagesa për personelin e rektoratit dhe të administratës qendrore deri muajin shkurt të vitit 2018.

Këshilli Drejtues, me Vendimin me nr. prot. 3/508, datë 14.10.2022, ka emëruar komisionin për plotësimin-ndryshimin e Rregullores me nr. prot. 2/513, datë 25.10.2013, plotësuar-ndryshuar me Vendimin me nr. prot. 1/630, datë 14.7.2016. Komisioni është në fazën e hartimit të draftit të rregullores që do t'i propozohet për miratim Këshillit Drejtues, me të cilën ndër të tjera do të përcaktohet edhe forma e ndarjes së mjeve të realizuara.

Duke u mbështetur në atë çfarë u tha më lart, KD-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

- Arkivit të UP-së,
- Anëtarëve të KD-së,
- Zyrës për buxhet dhe financa,
- Zyrës ligjore,
- Asistentes së KD-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Alm Shani, kryesues